



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E EKONOMISË  
DHE INOVACIONIT

# 2025

# RAPORTI

# VJETOR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E PRONËSISË INDUSTRIALE



[www.dppi.gov.al](http://www.dppi.gov.al)

## **Raport Vjetor 2025**

### **Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)**

Adresa: Bulevardi “Zhan

D’Ark”, Prona nr.33, Ish-Shtëpia e

Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri

E-mail: info@dppi.gov.al

Web: www.dppi.gov.al

Numri i Gjelbër: 0800 1993

### **Tabela e Lëndës**

Shkurtesat

Hytje

Pronësia Industriale

Fjala përshëndetëse nga Drejtori i Përgjithshëm i komanduar i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Qëllimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale

Statusi

Misioni

Fokusi

Objektivat

Të dhëna statistikore mbi objektet e pronësisë industriale

Aplikime për regjistrimin e markave tregtare

Aplikime për regjistrimin e markave tregtare sipas Marrëveshjes së Madridit (marka ndërkombëtare)

Aplikime për rinovimin e markave tregtare

Certifikata regjistrimi të lëshuara nga DPPI

Disenjot industriale në Republikën e Shqipërisë

Aplikime për regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës

Dhoma e Kundërshtimeve

Dhoma e Revokimit dhe Pavlefshmërisë dhe Çështjet Gjyqësore

Patentat për Shpikje dhe Modelet e Përdorimit  
Të dhëna statistikore për vitin 2025  
Aplikimet e Patentave  
Aplikimet për Patenta Kombëtare  
Aplikimet për Patenta Europiane  
Aplikimet për Patenta Ndër Vite  
Statistikat nga Ekzaminimi i Patentave  
Aplikimet për Modelet e Përdorimit  
Grafikët  
Akte Administrative të Publikuara  
Arritjet  
Marrëveshjet e Bashkëpunimit  
Projekte  
Takime/Konferenca/Workshope  
Eventet e trajnimeve  
Qendrat e Informacionit Tekniko- Shkencore  
Pjesëmarrja në Panaire dhe Aktivitetet e Promovimit  
Aktivitete të tjera Promovimi  
Iniciativat ligjore në fushën e Pronësisë Industriale  
Miratimi dhe Hyrja në Fuqi e Ligjeve me nr. 52/2025 dhe nr. 53/2025  
Traktatet dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare  
Hartimi dhe Monitorimi i Projektvendimeve dhe Projektligjeve  
Tabela Përmbledhëse e Aktiviteteve/Eventeve (2024-2025)  
Procesi i Integritit European  
Kapitulli 7: “Ligji i Pronësisë Intelektuale - Një shembull suksesi në rrugën europiane të Shqipërisë”  
Rendësia e Kapitullit 7  
Progresi i Shqipërisë në Kapitullin 7  
Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Përputhja me Standartet e BE-së  
Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Publikut  
Hapat e Fundit për Mbylljen e Kapitullit 7  
Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022-2025  
Statistikat  
Analizë e Përgjithshme e Performancës së të Ardhurave  
Të ardhurat nga Zyra Europiane e Patentave (EPO)  
Përfundim ekonomik  
Mirënjohje

## **SHKURTIME:**

DPPI - Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

MEI – Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit

BE - Bashkimi Evropian

EPO - European Patent Office

EUIPO - European Union Intellectual Property Office

INTA - Shoqata Ndërkombëtare e Markave Tregtare

OBPI - Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

PI - Pronësia Intelektuale

PKIE- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian

QTT - Qendrat e Transferimit të Teknologjisë

QITSH - Qendrat e Informacionit Teknik-Shkencor

ZBEPI - Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale

ZEP - Zyra Evropiane e Patentave

WIPO - Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

TGJ- Tregues Gjeografik

EO – Emërtim Origjine

DAP – Departamenti i Administratës Publike

## PRONËSIA INDUSTRIALE

---

Ky raport pasqyron në mënyrë të përmbledhur zbatimin dhe ndikimin e standardeve në fushën e pronësisë industriale, si dhe nivelin e efikasitetit dhe profesionalizmit të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Raporti bazohet në të dhënat statistikore të përpunuara nga drejtoritë dhe sektorët përbërës të DPPI-së, mbi punën e realizuar gjatë vitit 2025.

Raporti Vjetor i DPPI-së, shërben si një mjet komunikimi dhe transparence, përmes të cilit përcillen tek lexuesi informacionet kryesore mbi veprimtarinë e institucionit dhe volumin e punës së kryer. Njëkohësisht, ky raport kontribuon në zbatimin efektiv të legjislacionit për pronësinë industriale dhe në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale përcakton në mënyrë të qartë strategjitë, objektivat afatshkurtra dhe afatmesme, në funksion të realizimit të vizionit të saj institucional. Objektivi kryesor i DPPI-së është ofrimi i një mbrojtjeje të plotë të pronësisë industriale, në përputhje me standardet evropiane, përmes rritjes së cilësisë së ekzaminimit të objekteve të pronës industriale dhe ndërgjegjësimit të publikut, mbi të drejtat që burojnë nga regjistrimi i tyre.

Përfitimet që rrjedhin nga mbrojtja e objekteve të pronësisë industriale, përbëjnë një faktor të rëndësishëm nxitës për zhvillimin ekonomik të bizneseve dhe krijimin e një konkurrence të ndershme në treg, duke i kthyer ato në kontribues të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë kombëtare.

Pikërisht për këtë arsye, ndërtimi i një sistemi kombëtar funksional dhe të besueshëm të pronësisë industriale është thelbësor, pasi krijon një mjedis stimulues ku bizneset, industritë dhe individët ndihen të sigurt se puna, inovacioni dhe investimet e tyre janë të mbrojtura nga vjedhja, falsifikimi dhe keqpërdorimi.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale përbën një hallkë kyçe të sistemit, duke qenë institucioni përgjegjës për politike bërjen në fushën e pronësisë industriale dhe përfaqësuesi i vetëm i Republikës së Shqipërisë, pranë organizmave ndërkombëtare, për çështjet e pronësisë intelektuale.

Në raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025, në kuadër të Kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale”, vlerësohet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë, ndërsa rekomandohet vijimi i harmonizimit të legjislacionit dhe pronësinë industriale me *acquis* të Bashkimit Evropian, si dhe forcimi i sistemit të zbatimit të këtyre të drejtave.

Duke u mbështetur në këto vlerësime dhe me bindjen se zhvillimi i sistemit të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë është në drejtimin e duhur, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale do të vijojë me përkushtim dhe vendosmëri forcimin e bashkëpunimeve dhe dialogut me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit, me synimin për të përmbushur misionin e saj institucional dhe për të nxitur zhvillimin e inovacionit në vend.



## **FJALA PËRSHËNDETËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOMANDUAR TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE**

*I nderuar lexues,*

Përmes publikimit të Raportit Vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, kam kënaqësinë të ndaj me ju punën dhe arritjet e këtij institucioni gjatë vitit 2025.

Ky raport, shërben si një mjet i rëndësishëm transparence dhe llogaridhënieje, ku prezantohen rezultatet dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit kalendarik 2025. Ky vit, ka përfaqësuar një periudhë me rezultate të spikatura për DPPI-në, ku shifrat pasqyrojnë punën e palodhur të të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin e pronësisë industriale, duke përfshirë bizneset vendase

dhe ato të huaja, të cilat kanë treguar interes të veçantë për tregun shqiptar.

Këto rezultate janë dëshmi e angazhimit dhe bashkëpunimit të të gjithë pjesëmarrësve në sistemin e Pronësisë Industriale, të cilët kanë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin me sukses të objektivave të institucionit tonë.

Gjatë vitit 2025, DPPI-ja ka përparuar ndjeshëm proceset e saj digjitale, duke ofruar shërbimet tërësisht nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania. Eliminimi i protokollimit fizik dhe qarkullimi i menjëhershëm i aplikimeve ka përsheptuar ndjeshëm kohën e ekzaminimit dhe ka garantuar një shërbim më efikas ndaj qytetarëve. Proceset e skanimit, indeksimit dhe delegimit të dokumentacionit janë përmirësuar, duke reduktuar gabimet dhe duke lehtësuar aksesin në aktet administrative në sistemin SAPI, në kohë reale.

DPPI, ka intensifikuar bashkëpunimet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke nënshkruar gjatë vitit 2025, 10 Memorandume Bashkëpunimi kombëtare me institucionet vendase dhe 3 Memorandume Bashkëpunimi, me zyrat homologe partnere.

DPPI, ka vijuar punën për përmirësimin e bazës ligjore, duke përafuar legjislacionin shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian.

Një nga zhvillimet kryesore të vitit 2025, ka qenë miratimi dhe hyrja në fuqi më 16 gusht 2025 e “Ligjit nr. 52/2025 “Për markat tregtare” dhe Ligjit nr. 53/2025 “Për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë”. Gjithashtu, po gjatë këtij viti, u miratuan nga Këshilli i Ministrave Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin për Pronësinë Intelektuale, Burimet Gjenetike dhe Njohuritë Tradicionale të lidhura me to” (Gjenevë, 24 maj 2024) dhe Projektligji “Për ratifikimin e Traktatit të Riadit për Disenjt dhe Rregullores sipas këtij Traktati” (Riad, 22 nëntor 2024).

DPPI, ka përfunduar vitin 2025 me një rritje të ndjeshme në aplikimet për patentat për shpikje, disenjot industriale dhe markat tregtare, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve dhe performancën institucionale.

Në përfundim, dëshiroj të shpreh falënderimet e mia të sinqerta:

- institucioneve partnere dhe aktorëve të përfshirë në sistemin e PI-së;
- anëtarëve të grupit ndër-institucional të punës të Kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale”;
- Organizatave Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale, përfshirë OBPI, EPO dhe EUIPO, për mbështetjen e vazhdueshme teknike dhe vlerësimin e performancës sonë.


Një falënderim i veçantë gjithashtu i shkon padiskutim stafit të DPPI-së, për përkushtimin, këmbënguljen dhe profesionalizmin e treguar, që mundësoi përmbushjen me sukses të të gjitha objektivave të vendosura për vitin 2025.

*Me respekt,*

**RUDINA BOLLANO**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR**

## ORGANIGRAMA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE



### QËLLIMI I VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) është një institucion publik jo buxhetor, me seli në Tiranë, Shqipëri me adresë: Bulevardi Zhan D'Ark, Prona nr. 33, Ish Shtëpia e Ushtarakëve. DPPI, ka për mision regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të pronësisë industriale. DPPI funksionon si një agjenci autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për fushën e ekonomisë.

Përveç rolit të saj administrativ dhe rregullator, DPPI kontribuon në mënyrë aktive në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së pronës industriale, duke bashkëpunuar me palët e interesuara, aktorët e përfshirë në sistem, si dhe me universitetet dhe institucionet arsimore në të gjithë vendin.

### STATUSI

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

DPPI është institucioni i vetëm përmes të cilit shteti shqiptar njeh dhe garanton të drejtat mbi patentat për shpikjet dhe modelet e përdorimit, topografisë e produkteve gjysmëpërçuese, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale, si dhe treguesit gjeografikë. Përmes procesit të regjistrimit, mbajtësve të këtyre të drejtave u njihet pronësia ligjore mbi objektet përkatëse.

Në këtë kuadër, DPPI ushtron gjithashtu rolin e koordinatorit të Kapitullit 7 “Pronësia Intelektuale”, duke raportuar mbi ecurinë dhe veprimtarinë e saj pranë Komitetit të Stabilizim-Asociimit, Nënkomitetit të Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës, si dhe pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet strategjike dhe procesi i integritetit evropian.

## MISIONI

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale synon të jetë një institucion modern, i besueshëm dhe i krahasueshëm me institucionet homologe të Bashkimit Evropian, që garanton mbrojtje efektive të pronësisë industriale dhe ofron shërbime cilësore, transparente dhe të orientuara drejt përdoruesit. Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve institucionale, përafrimit të vazhdueshëm me standardet evropiane dhe promovimit të inovacionit, DPPI synon të kontribuojë në krijimin e një mjedisi ekonomik konkurrues, që nxit zhvillimin e qëndrueshëm, investimet dhe ekonominë e bazuar në dije në Republikën e Shqipërisë.

## FOKUSI

Në fokus të DPPI-së qëndron përmirësimi i funksionimit të sistemit të pronësisë industriale, me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit në vend. Ky qëndrim realizohet përmes stimulimit të punës kërkimore dhe zhvillimit, veçanërisht nga kompanitë, universitetet dhe individët shqiptarë, duke krijuar një mjedis që favorizon investimet në kërkim dhe zhvillim dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Sistemi i pronësisë industriale shërben, po ashtu, si një mjet për të siguruar konkurrencën e ndershme dhe suksesin e subjekteve shqiptare në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar.

## OBJEKTIVAT

- ❖ Rritja e cilësisë së ekzaminimit dhe shkurtimi i afateve të procedurave të ekzaminimit
- ❖ Menaxhim dhe koordinim i efektshëm për të përmirësuar mbrojtjen dhe zbatimin e pronësisë intelektuale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- ❖ Forcim i marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe partneriteteve strategjike, për një organizim efikas dhe të qëndrueshëm.

## TË DHËNA STATISTIKORE PËR OBJEKTET E PRONËSISË INDUSTRIALE

---

### Aplikime për regjistrim marke:

Përgjatë vitit 2025 janë paraqitur për regjistrim marke 1995 aplikime, pranë Drejtorisë së Përgjithshme

të Pronësisë Industriale, kurse gjatë vitit 2024 janë paraqitur për regjistrim marke në total 1575 aplikime, në vitin 2023 janë paraqitur 1311 aplikime dhe në vitin 2022 janë paraqitur 1165.

Pra, vihet re një rritje e konsiderueshme e numrit të aplikimeve për regjistrim marke prej 16.8 %, sipas grafikut të mëposhtëm:

### **Aplikime për regjistrim marke nga Marrëveshja e Madridit (Markat Ndërkombëtare)**


Marrëveshja e Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave (1891) është një traktat ndërkombëtar i menaxhuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO). Ajo mundëson regjistrimin e markave në shumë shtete përmes një procedure të vetme dhe një aplikimi ndërkombëtar. Kjo sistematizon dhe thjeshton regjistrimin e markave për subjektet që dëshirojnë të mbrojnë markën e tyre në shumë shtete.

Kjo marrëveshje është një mjet i rëndësishëm për bizneset që kërkojnë të zgjasin mbrojtjen e markave të tyre në tregje të ndryshme dhe të shmangin kompleksitetet e regjistrimeve të veçanta për çdo vend. Protokollin e Madridit (i miratuar në vitin 1989) është një dokument që ka për qëllim të modernizojë dhe të përmirësojë sistemin e Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave. Protokollin është një shtesë dhe një alternativë që e bën regjistrimin ndërkombëtar më të thjeshtë dhe më fleksibël për shumë shtete.

Shqipëria ka aderuar në Marrëveshjen e Madridit më 1 shtator 1993 dhe më pas ka aderuar gjithashtu në Protokollin e Madridit më 25 mars 2008.

Kjo do të thotë që aplikantët shqiptarë mund të përfitojnë nga mundësitë e ofruara nga të dyja sistemet për regjistrimin e markave ndërkombëtare, si dhe mund të kërkojnë mbrojtje në shtetet që janë pjesë e këtyre marrëveshjeve.


Gjatë vitit 2025, për shtrirjen e mbrojtjes për Republikën e Shqipërisë ishin në total 2344 aplikime ndërkombëtare, për vitin 2024 ishin 2677 aplikime, për vitin 2023 ishin në total 2954 aplikime, për vitin 2022 ishin në total 2017 aplikime për regjistrim marke nga Marrëveshja e Madridit.



#### **Aplikime për ripërtëritje marke:**

Marka mund të ripërtërihet pafundësisht për periudha dhjetëvjeçare, pasi pronari depoziton një kërkesë për këtë qëllim në DPPI dhe paguan tarifën përkatëse.

Përgjatë vitit 2025 janë paraqitur 765 aplikime për ripërtëritje marke, në vitin 2024 numri i aplikimeve ishte në total 569, në vitin 2023 numri i aplikimeve ishte 485 dhe në vitin 2022 numri i aplikimeve për ripërtëritje marke ishte 535.




Ajo që vihet re nga grafikët e mësipërm, është trendi në rritje për regjistrimet ndërkombëtare të cilat kërkojnë të shtrijnë mbrojtjen dhe për Shqipërinë.

### **Certifikata Regjistrimi të lëshuar nga DPPI**

Për sa u përket certifikatave të regjistrimit për markat, përgjatë vitit 2025 DPPI-ja ka lëshuar 1705 certifikata regjistrimi, në vitin 2024 janë lëshuar 1020 certifikata regjistrimi, në vitin 2023 janë lëshuar 1087 certifikata regjistrimi dhe në vitin 2022 janë lëshuar 963 certifikata regjistrimi për markat tregtare.






Siç duket edhe nga tabela krahasimore më sipër, vihet re një rritje prej afërsisht 34 % e aplikimeve për ripërtëritjen e markave të regjistruara për një periudhë shtesë prej 10 vjetësh.

### **APLIKIME PËR REGJISTRIM TREGUESI GJOGRAFIK DHE EMËRTIME ORIGJINE**

Për sa u përket aplikimeve për regjistrim Treguesi Gjeografik/ Emërtime Origjine, pranë DPPI-së është paraqitur në vitin 2025 në total 1 aplikim, në vitin 2024 në total 2 aplikime, në vitin 2023 janë paraqitur 3 aplikime, në vitin 2022 është paraqitur vetëm 1 aplikim për regjistrim Treguesi Gjeografik/ Emërtime Origjine.



Numri i Treguesve Gjeografikë/ Emërtim i Origjinës të cilët janë regjistruar deri më tani është 33 nga 39 kërkesa aplikimi të depozituara në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë. Gjatë viteve të fundit, vihet re një trend në ulje i aplikimeve për regjistrim TGI/ EO


Numri i Treguesit Gjeografik/Emërtim i Origjinës të cilët janë regjistruar deri më tani, është 22 nga 30 kërkesa aplikimi të depozituara në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë. Gjatë viteve të fundit, vihet re një trend në rritje i aplikimeve për regjistrim TGI/EO nga aplikantët shqiptarë.

## Disenjt Industrialë në Republikën e Shqipërisë

Në Republikën e Shqipërisë, Disenjt Industrialë mbrohen nëpërmjet regjistrimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, e cila zbaton të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e tyre, si dhe nëpërmjet sistemit të Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të tyre.

Marrëveshja e Hagës është një traktat ndërkombëtar që mundëson regjistrimin e Disenjove Industriale në një nivel global përmes një procedure të thjeshtë dhe të centralizuar. Ky sistem, menaxhohet nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe u krijua për të ofruar mbrojtje për disenjon industriale në shumë shtete me një aplikim të vetëm.

Përgjatë vitit 2025 në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë paraqitur në total 26 aplikime për regjistrimin e disenjove industriale, kurse në vitin 2024 janë paraqitur 35, në vitin 2023 janë paraqitur 38 dhe në vitin 2022 janë paraqitur 19 aplikime për regjistrim Disenjo Industriale, sipas tabelës së mëposhtme:



Ndërkohë, për sa u përket aplikimeve për ripërtëritjen e Disenjove Industriale të mbrojtur, përgjatë vitit 2025 janë paraqitur 7 aplikime në total, në vitin 2024 janë paraqitur 3 aplikime, në vitin 2023 janë paraqitur 5 aplikime dhe në vitin 2022 janë paraqitur 7 aplikime për ripërtëritjen e Disenjove Industriale.

Regjistrimi i Disenjove Industriale, mund të ripërtërihet kundrejt një pagese të caktuar për një periudhë shtesë prej pesë vjetësh, deri në një periudhë prej 25 vjetësh.

## DHOMA E KUNDËRSHTIMEVE

---


Dhoma e Kundërshtimeve është krijuar në bazë të nenit 193, të ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, e cila ka si objekt të veprimtarisë së saj shqyrtimin e kërkesave për kundërshtim dhe observim.

Dhoma e Kundërshtimeve është një strukturë e ngritur pranë DPPI-së dhe ka në përbërje të saj 3 anëtarë të kësaj njësie, të emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Kjo dhomë ka filluar të funksionojë pas hyrjes në fuqi në datën 06.06.2018 të VKM nr. 315, datë 31.5.2018 “Për miratimin e rregullores për markat”, që parashikon procedurën administrative për shqyrtimin e kërkesave drejtuar kësaj dhome.

Përgjatë vitit 2025 janë depozituar 117 kërkesa për kundërshtimin e dhënies së pronësisë industriale për markë të publikuar, për të cilat është vendosur si më poshtë:

- Vendim për pranimin e plotë të kërkesës për kundërshtim - 5 vendime
- Vendim për refuzimin e kërkesës për kundërshtim - 6 vendime
- Në proces kundërshtimi - 106 aplikime, për të cilat është lëshuar “Njoftim për plotësim të metash në kërkesën për kundërshtim” dhe “Njoftim për pjesëmarrje në procedurë kundërshtimi”.



## DHOMA PËR SHFUQIZIM DHE PAVLEFSHMËRI DHE ÇËSHTJET GJYQËSORE

Veprimtaria e DPPI-së, në Dhomën për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri dhe në gjykatë ka njohur një rritje të ndjeshme gjatë viteve 2024–2025. Ky zhvillim reflekton intensifikimin e veprimtarisë administrative dhe gjyqësore si pasojë e reformave ligjore dhe rritjes së ndërgjegjësimit të subjekteve për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale.

### PATENTAT PËR SHPIKJE DHE MODELET E PËRDORIMIT

#### TË DHËNA STATISTIKORE PËR VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, pranë DPPI-së, ka pasur **659 aplikime për patenta nga të cilat, 11 janë aplikim për patentë kombëtare/PCT** me aplikantë shtetas Shqiptarë dhe **648 aplikime për patenta**, janë patenta të lëshuara nga Zyra Evropiane e Patentave, të cilat kërkojnë mbrojtje në Shqipëri.


#### APLIKIME PËR PATENTA

APLIKIME	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Aplikime për Patentë Kombëtare	12	23	20	9	12	10
Patenta nga Zyra Evropiane e Patentave	885	923	601	658	730	648
Aplikime nga Traktati i Bashkëpunimit	1	2	0	3	0	1
Aplikime për Certifikatë të mbrojtjes shtesë	1	3	4	4	11	3
<b>TOTALI PATENTA</b>	898	948	620	667	742	659

**Tabela 1. Aplikime për Patenta Kombëtare**


Aplikimet kombëtare, janë kryesisht të fushës mekanike dhe ushqimore

8 patenta, janë të fushës së artikujve personalë/ shtëpiakë (nevoja njerëzore)




**Tabela 2. Aplikime për patenta evropiane**

Aplikime për shtrirje/njohje të vlefshmërisë së patentave evropiane



**Tabela 3. Aplikime për patenta në vite**

Grafiku i mëposhtëm tregon trendin e aplikimeve për patenta, të depozituara në vite.



### STATISTIKA TË EKZAMINIMIT TË PATENTAVE

<b>PATENTA PËR SHPIKJE</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
Totali kërkesave për regjistrimin e patentave	742	659
Kërkesa për regjistrimin patentave evropiane (vlefshmëri/shtrirje)	730	648
Numri i patentave të regjistruara (vlefshmëri)	808	645
Kërkesa për regjistrim Patentë Kombëtare/ PCT	12	11
Patenta Kombëtare të regjistruara	13	7
Aplikime për Certifikatë të mbrojtjes shtesë	11	3
Certifikatës së mbrojtjes shtesë (SPC) të regjistruara	7	7
Aplikime për modele përdorimi	4	1
Modele përdorimi të regjistruara	1	3
Kërkesa për ripërtëritjen patentës	5153	5172
Numri i patentave të ripërtëritura	5279	5118

Kërkesa për ndryshime në regjistrin e patentave	183	143
Ndryshime në regjistrin e patentave	173	140
Kërkesa për rivendosje në afat të patentës	11	8
Rivendosje në afat të shqyrtuara	12	8
Aplikime për patentë të refuzuara	40	19
Patenta të skaduara	1029	218
Korrigjime të gabimeve	56	34
Kërkesa për shtyrje afati	35	18
Njoftime gjatë procesit të ekzaminimit	254	361
Dokumente në total të lëshuara	7959	6861


## APLIKIME PËR MODELE PËRDORIMI

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, janë depozituar 2 aplikime, gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë depozituar 4 aplikime për regjistrim të modeleve të përdorimit, ndërkohë që për periudhën janar-dhjetor 2023, ka pasur vetëm 3 aplikime për model përdorimi.

### Aplikime për model përdorimi

APLIKIME	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Aplikime për model përdorimi	1	2	3	3	3	4	2

Tabela 4. Aplikime për modele përdorimi



## Klasifikimi i Mallrave dhe Shërbimeve sipas Nicës – Grupim Tematik

### Analiza e aplikimeve sipas kategorive

<b>Kategori</b>	<b>Aplikime</b>	<b>%</b>
M. Biznes, Financa dhe Shërbime Profesionale	1417	36.19
K. Ushqim dhe Pije	575	14.69
G. Shëndet dhe Kujdes Personal	487	12.44
J. Art, Muzikë, Edukim dhe Sport	259	6.62
H. Moda, Aksesorë dhe Lëkurë	216	5.52
D. Teknologji dhe Elektronikë	208	5.31
I. Shtëpia, Enët dhe Dekori	197	5.03
C. Makineri dhe Pajisje Industriale	188	4.8
A. Shkencë, Kimikate dhe Bujqësi	99	2.53
B. Materiale dhe Ndërtim	79	2.02
L. Duhan dhe Alternativa	77	1.97
E. Transport dhe Automobilitet	62	1.58
N. Tekstile dhe Fije	51	1.3
F. Siguri dhe Mbrojtje	0	0.0

Aplikimi për marka tregtare sipas klasave të Nicës, grupuar në kategori tematike.

#### Pikat kryesore:

- Totali i aplikimeve për mallra dhe shërbime.
- Kategoritë me peshën më të madhe.
- Trendi kryesor për vitin 2025.

#### Statistika

- Tabela përmbledhëse e aplikimeve sipas kategorive:


<b>Kategori</b>	<b>Aplikime</b>	<b>%</b>
M. Biznes, Financa dhe Shërbime Profesionale	1417	36.19%
K. Ushqim dhe Pije	575	14.69%
G. Shëndet dhe Kujdes Personal	487	12.44%
J. Art, Muzikë, Edukim dhe Sport	259	6.62%
H. Moda, Aksesorë dhe Lëkurë	216	5.52%

D. Teknologji dhe Elektronikë	208	5.31%
I. Shtëpia, Enët dhe Dekori	197	5.03%
C. Makineri dhe Pajisje Industriale	188	4.80%
A. Shkencë, Kimikate dhe Bujqësi	99	2.53%
B. Materiale dhe Ndërtim	79	2.02%
L. Duhan dhe Alternativa	77	1.97%
E. Transport dhe Automobilizëm	62	1.58%
N. Tekstile dhe Fije	51	1.30%
F. Siguri dhe Mbrojtje	0	0.00%

- Kategoria më e madhe: **Biznes, Financa dhe Shërbime Profesionale (36.19%)**
- Kategoritë kryesore për mallra: **Ushqim dhe Pije (14.69%), Shëndet dhe Kujdes Personal (12.44%)**


#### Grafikët:

Numri i aplikimeve sipas kategorive të mëdha



- Përqindja e aplikimeve sipas kategorive.

Ndarja e aplikimeve sipas kategorive të mëdha (%)




## Grafikët

- **Mallra**

(Klasa


1–34)




• Shërbime



(Klasa

35–45)



Grafiku (Numri i aplikimeve sipas kategorive)





## Grafiku (Ndarja në %)

### Kryesore

- Shërbimet profesionale (Biznes, Financa, etj.) dominojnë me 36.19% të aplikimeve.
- Ushqim dhe Pije, është kategoria e dytë më e madhe me 14.69%.
- Shëndet dhe Kujdes Personal, zë vendin e tretë me 12.44%.
- Kategoritë teknologjike dhe artistike kanë peshë mesatare (5–6% secila).

### Akte administrative të nxjerra

Gjatë vitit 2025, DPPI ka lëshuar **gjithsej 6861** akte administrative për patentat, modelet e përdorimit dhe ndryshimet në regjistër lidhur me to.

Tabela e mëposhtme tregon kërkesat si dhe aktet e lëshuara nga DPPI-ja gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024-2025

PATENTA PËR SHPIKJE	2024	2025
Totali kërkesave për regjistrimin e patentave	742	659
Kërkesa për regjistrimin patentave evropiane(vlefshmëri/shtrirje)	730	648
Numri i patentave të regjistruara (vlefshmëri)	808	645
Kërkesa për regjistrim Patentë Kombëtare/ PCT	12	11

Patenta Kombëtare të regjistruara	13	7
Aplikime per Certifikatë të mbrojtjes shtesë	11	3
Certifikatës së mbrojtjes shtesë (SPC) të regjistruara	7	7
Aplikime për modele përdorimi	4	1
Modele përdorimi të regjistruara	1	3
Kërkesa për ripërtëritjen patentës	5153	5172
Numri i patentave të ripërtërira	5279	5118
Kërkesa për ndryshime në regjistrin e patentave	183	143
Ndryshime në regjistrin e patentave	173	140
Kërkesa për rivendosje në afat të patentës	11	8
Rivendosje në afat të shqyrtuara	12	8
Aplikime për patentë të refuzuara	40	19
Patenta të skaduara	1029	218
Korrigjime të gabimeve	56	34
Kërkesa për shtyrje afati	35	18
Njoftime gjatë procesit të ekzaminimit	254	361
Dokumente në total të lëshuara	7959	6861

## REALIZIMET

Të gjitha aplikimet në lidhje me objektet e PI-së, aplikohen nëpërmjet platformës e-Albania dhe i gjithë procesi i ekzaminimit kryhet dhe menaxhohet on-line nëpërmjet sistemit SAPI, që prej datës 31 korrik 2023.

Aktivite promovuese të objekteve të PI-së

5 Pjesëmarrje në aktivite ndërkombëtare:

8 Trajnime, workshop, seminare online të organizuara nga EPO Academy dhe WIPO:

16 trajnime Online të organizuara nga EPO Academy dhe WIPO

Gjatë muajit tetor 2025, DPPI, punoi intensivisht me ekspertët e EPO në kuadër të projektit pilot të financuar nga EPO “Bashkëpunim për forcimin e kapaciteteve kombëtare në kërkimin dhe ekzaminimin e patentave”.

**Të tjera:**

18	Ekzaminime kërkesash për TBP
153	Ekstrakte të lëshuara
2	Përgjigje inspektimesh
89	Përgjigje hetimesh

**DPPI ka publikuar:**

33 Buletinë të Pronësisë Industriale, nga 12 të parashikuar në ligj

**18 Ka informuar nëpërmjet postës elektronike publikun me:**

1036 e-mail-e informuese .

## **AKTIVITETE PROMOVUESE**

Gjithashtu, DPPI ka ndërmarrë bashkëpunime teknike në formën e marrëveshjeve dypalëshe me zyrat homologe rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar marrëveshje ndërinstitucionale për krijimin e Qendrave të Informacionit Teknik Shkencor, duke mundësuar bashkëpunime të mëtejshme në fushën e përgjegjësisë.

Gjithashtu, DPPI vijon koordinimin e punës me organizatat ndërkombëtare WIPO, EPO dhe EUIPO, sipas marrëveshjeve teknike ekzistuese. Këto bashkëpunime, kanë mundësuar ofrimin e shërbimeve të reja, përfitimin e asistencës teknike dhe profesionale të avancuar, rritjen e kapaciteteve administrative dhe institucionale të ofruara ndaj publikut.

## **MEMORANDUME BASHKËPUNIMI**


Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi teknike, me Zyrat homologe, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Industriale 2022-2025, konkretisht:

- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Zyrës së Pronësisë Intelektuale të Hungarisë (HIPO)
- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Drejtorisë së Pronësisë Industriale të Republikës së Çekisë.



## PROJEKTE

- Shqipëria prezantoi për herë të parë produktet si Tregues Gjeografik në WIPO



Më 10 korrik 2025, në Gjenevë, gjatë Asamblesë së 66<sup>te</sup> të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), Shqipëria organizoi për herë të parë një panair (side event) me temë "Treguesit

Gjeografikë dhe shprehjet e Traditës Kulturore" Në këtë ngjarje, u promovuan disa produkte shqiptare të regjistruara si Tregues Gjeografikë: Vaji i ullirit Valmi, Mjalti i Bedunicës, Kërpudha e Pukës, Qepa e thatë e Drishtit, Kumbulla e Shumbatit, si dhe Specialiteti Tradicional i Garantuar Glikoja e Përmetit.

Aktiviteti u përshëndet nga z. Daren Tang, Drejtor i Përgjithshëm i WIPO, i cili vlerësoi angazhimin e Shqipërisë në fushën e pronësisë industriale.

Mbrëmja u shoqërua me performanca artistike nga Ansambli Kombëtar dhe një ekspozitë veshjesh popullore, duke ofruar gjithashtu degustim të recetave shqiptare për delegatët ndërkombëtarë. Ky aktivitet përfaqësoi një hap të rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.

## TAKIME

- **Takim Zyrtar Bilateral në Fushën e Pronësisë Industriale**



Në Prishtinë, u zhvillua një takim zyrtar bilateral ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Komanduar të Agjencisë për Pronësi Industriale të Republikës së Kosovës, Avdi Krasniqi, dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Komanduar të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, të Republikës së Shqipërisë, znj. Rudina Bollano.

Takimi u mbajt në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet dy institucioneve homologe, me qëllim forcimin dhe thellimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e pronësisë industriale. Për zbatimin e kësaj marrëveshje është krijuar Komiteti i Monitorimit, i cili përbëhet nga përfaqësues të dy institucioneve përkatëse.

Takimi rikonfirmoi angazhimin e ndërsjellë për intensifikimin e bashkëpunimit institucional dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të pronësisë industriale në të dy vendet, në përputhje me standardet ndërkombëtare

- **Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale mori pjesë në sesionin e 17<sup>te</sup> të Komitetit Këshillimor për Zbatimin (ACE), organizuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO).**

Shqipëria u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar, znj. Maria Solis.

Gjatë takimit, znj. Solis u mirëprit nga Drejtori i Përgjithshëm i WIPO, z. Daren Tang. Ata diskutuan për situatën aktuale të Pronësisë Industriale në Shqipëri, duke theksuar sfidat dhe vizionin për të ardhmen. Z. Tang siguroi mbështetje të plotë për Shqipërinë në përpjekjet e saj për forcimin e sistemit të Pronësisë Industriale.

Një tjetër takim i rëndësishëm u zhvillua me z. Habip Asan, Drejtor i Divizionit për Tranzicion dhe Zhvillim të Shteteve në WIPO. Diskutimet u përqëndruan në thellimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe WIPO, përmes iniciativave kyçe, përfshirë mbështetje për të rinjtë, transferimin e teknologjisë, programet e trajnimit për prokurorët dhe organizimin e kampeve verore.

Këto nisma, synojnë të krijojnë një ekosistem dinamik dhe të fuqishëm të Pronësisë Industriale.

Në mesazhin e tij, z. Habip Asan theksoi rëndësinë e partneriteteve strategjike dhe bashkëpunimit të ngushtë me vendet anëtare të WIPO, si Shqipëria, për arritjen e objektivave të përbashkëta për vitin 2025. Ai theksoi: "Ne shpresojmë të forcojmë më tej bashkëpunimin tonë me Shqipërinë dhe të eksplorojmë rrugë të reja bashkëpunimi. Së bashku, ne mund të ndërtojmë një ekosistem PI të sigurt, inovativ dhe gjithëpërfshirës, për të mirën e të gjithëve."

- **Takimi Tre-Palësh për Forcimin e Bashkëpunimit Rajonal në Fushën e Pronësisë Industriale**

Në muajin shkurt 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, organizoi një takim tre-palësh me homologët e saj nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut, në kuadër të bashkëpunimit rajonal për çështjet e pronësisë industriale.

Ky takim shënon një hap të rëndësishëm në thellimin e marrëdhënieve institucionale dhe koordinimin e projekteve të përbashkëta, me synimin për të përmirësuar shërbimet dhe përfaqësimin ndërkombëtar të rajonit.

Delegacionet pjesëmarrëse u mirëpritën nga Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar i DPPI, znj. Maria Solis.

Pjesëmarrësit në takim:

- Z. Avdi Krasniqi – Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Pronësisë Industriale të Kosovës
- Z. Eljesa Neziri - Drejtor i Përgjithshëm i Entit për Pronësi Industriale të Maqedonisë së Veriut
- **Liaison meeting on Cooperation, Trademark and Industrial Design**



Zyra e Pronësisë Intelktuale të Bashkimit Evropian (EUIPO) priti grupin e përdoruesve dhe takimet ndërlidhëse, duke ofruar një platformë të vlefshme për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi aktivitetet dhe iniciativat strategjike të Zyrës. Këto takime janë thelbësore për t'u dhënë zë përdoruesve dhe palëve të interesuara. Ato mundësojnë dëgjimin e drejtpërdrejtë të perspektivave të tyre mbi procedurat, praktikat dhe mjetet që i prekin ata. Duke nxitur një dialog të hapur, sigurojmë që strategjitë tona të jenë në përputhje me nevojat dhe pritshmëritë e atyre që u shërbejmë. Republika e Shqipërisë, mori pjesë me delegacionin e saj.

- **Konferencë e nivelit të lartë për Ditën Botërore të Pronësisë Intelktuale**

Me rastin e Ditës Botërore të Pronësisë Intelktuale, më 23 Prill, u organizua në Tiranë një konferencë e nivelit të lartë me temën "Nga ideja te ndikimi - Si i nxisin patentat startup-et dhe suksesin akademik". Aktiviteti u zhvillua nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në bashkëpunim me Zyrën Evropiane të Patentave (EPO) GIZ Albania, ICC Albania dhe CCI France-Albanie. Në fokus të konferencës ishte roli i patentave në përkrahjen e inovacionit dhe rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe sipërmarrëse, veçanërisht në universitetet dhe startup-et shqiptare. Në hapje, Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar i DPPI-së, znj. Maria Solis, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mbështetjes financiare për nxitjen e risive, Konferenca mbledhi aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfshirë përfaqësues nga Qeveria Shqiptare, EPO, GIZ, universitetet dhe komuniteti i biznesit. Mesazhe përshëndetëse u dhanë nga Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit, z. Blendi Gonxhja; Zëvendës-presidenti i EPO-s, z. Christoph Ernst; dhe përfaqësues të tjerë institucionalë dhe të biznesit.

Konferenca u strukturua në tre panele teknike, që trajtuan temat:

- Roli i universiteteve dhe politikave publike në nxitjen e inovacionit përmes PI-së,
- Fuqizimi i startup-eve përmes patentave dhe sfidat që ato përballen,
- Krijimi i një kulture të qëndrueshme të pronësisë industriale në Shqipëri.

Konferenca, shërbeu si platformë bashkëpunimi për ndarjen e praktikave më të mira dhe përcaktimin e hapave strategjikë për forcimin e sistemit të pronësisë industriale në vend.



- **Maj 2025 në Shkup, Maqedoni e Veriut, u zhvillua konferenca “Treguesit Gjeografikë: Trashëgimi e Përbashkët, Cilësi e Certifikuar”, pjesë e projektit rajonal për mbështetjen e territoreve me vlerë të lartë natyrore, në Ballkanin Perëndimor.**

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) ishte aktive në këtë ngjarje, duke dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në diskutimet teknike dhe strategjike që prekin:

- sfidat në mbrojtjen dhe certifikimin e Treguesve Gjeografikë (TGJ),
- përfshirjen e tyre si përbërës të gjurmueshëm në treg,
- përdorimin e teknologjisë blockchain për gjurmueshmëri,
- mbikëqyrjen doganore dhe monitorimin e tregut për parandalimin e mashtrimeve ushqimore,
- dhe rolin e TGJ-ve në zhvillimin e qëndrueshëm vendor.

Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin praktikues të Treguesve Gjeografikë nga vendet e Ballkanit: Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova, Bosnje – Hercegovina, Serbia, si dhe

përfaqësues të institucioneve franceze si CIRAD (Organizata Franceze për Kooperim dhe Kërkime në Bujqësi) dhe AIDA (Shoqata Ndërkombëtare për Integrimin e Agro-Mjedisor).

- Qershor 2025, Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, zhvilloi një **vizitë studimore pranë Organizatës Helene të Pronësisë Industriale (OBI)** në Athinë.

Fokusi ishte teknik dhe i drejtpërdrejtë:

- Struktura e një patente: si përgatitet, çfarë kërkesash përmbush dhe si vlerësohet për vlefshmëri.
- Procesi i dhënies së patentës dhe publikimi i saj, nga aplikimi deri te regjistrimi.
- Disenjat industriale: dokumentacioni, kriteret për mbrojtje dhe mënyra e dorëzimit.

Përfaqësuesit e DPPI u njohën nga afër me sistemin operativ të OBI-së, proceset digjitale të aplikimeve dhe mënyrën e menaxhimit të bazës së të dhënave për shpikje dhe marka.

Qëllimi: përmirësimi i standardeve teknike të shërbimeve tona dhe përafrimi me modelet më funksionale të rajonit.

- **Takim bilateral ndërmjet Zyrës Hungareze të Pronësisë Intelektuale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale në Tiranë**

Më 1 shtator 2025, në Tiranë u zhvillua takimi bilateral midis Zyrës Hungareze të Pronësisë Intelektuale (HIPO) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Shqipërisë (DPPI).

Delegacioni hungarez, i kryesuar nga Presidenti i HIPO, z. Szabolcs Farkas, dhe znj. Virág Adrienn Varga, Drejtuese e Përkohshme e Sektorit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, u mirëprit në Tiranë nga Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar i DPPI dhe drejtues të drejtorive përkatëse.

Gjatë takimit, palët diskutuan mbi forcimin e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e pronësisë industriale dhe shkëmbimin e përvojave institucionale. Palët ranë dakord për vendosjen e një ure të bashkëpunimit midis HIPO dhe DPPI, me synim rritjen e kapaciteteve teknike, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit rajonal dhe evropian në këtë fushë.

Ky takim shënoi një hap të rëndësishëm në thellimin e marrëdhënieve mes dy institucioneve homologe dhe kontribuon në përpjekjet e Shqipërisë për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të saj të pronës industriale.

- **Programi Kombëtar i Trajnimit për Mësuesit në fushat STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë)**

U zhvillua Programi Kombëtar i Trajnimit për Mësuesit në fushat STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë), me temë: “Inovacioni, Sipërmarrja dhe Edukimi mbi Pronësinë Intelektuale”.

Ky trajnim i nivelit të lartë u organizua nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe Ministrinë e Arsimit. Mësues, hartues kurrikulash dhe vendimmarrës në fushën e arsimit, do të përfituan nga ky program i specializuar për forcimin e kapaciteteve profesionale.

Ky aktivitet kishte si synim të integrojë edukimin mbi pronësinë intelektuale në sistemin parauniversitar shqiptar, duke e bërë atë pjesë të pandashme të formimit të brezave të rinj.

Përmes këtij procesi:

- Nxitet inovacioni dhe kreativiteti që në moshë të hershme,
- Forcohet kultura sipërmarrëse,
- Krijohen baza më të forta për zhvillim të qëndrueshëm arsimor dhe ekonomik.

## TRAJNIME

- **Sesioni i parë i programit të trajnimit të zhvilluar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Shqipërisë (DPPI) dhe Zyrën Shtetërore të Pronësisë Industriale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.**

Kjo seancë me temë “Hyrje në Transferimin e Teknologjisë”, bëri bashkë përfaqësues nga institucionet e inovacionit, akademia dhe kërkimi shkencor.

Ky program trajnimi, është një hap i vlefshëm drejt forcimit të kapaciteteve kombëtare dhe rajonale, në transferimin e teknologjisë dhe menaxhimin e pronësisë industriale.

Programi do të ndihmojë universitetet dhe institucionet kërkimore të fitojnë njohuritë dhe mjetet e nevojshme, për të shndërruar rezultatet e kërkimit në inovacion, produkte të reja dhe ndikim të prekshëm social dhe ekonomik .

Fjalët hyrëse u mbajtën nga Z.Michael Mbogoro, Kryetar i Seksionit të Transferimit të Teknologjisë pranë WIPO-s, si dhe përfaqësues të nivelit drejtues pranë DPPI.

Gjatë seancës, Znj. Olga Spasic, Znj. Olga Kusanova dhe Prof. Serdal Temel, ndanë përvoja praktike mbi nolitikat institucionale të pronësisë industriale. motivimin e studiuesve dhe rolin e

ekosistemit të inovacionit në ndërtimin e një kulture bashkëpunimi, ndërmjet kërkimit dhe industrisë.

- **Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) merr pjesë në Webinar-in Rajonal të WIPO, mbi Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ADR) në fushën e Kërkimit Shkencor (R&D) dhe Transferimit të Teknologjisë.**

Në këtë trajnim marrin pjesë gjithashtu përfaqësues të autorizuar dhe përfaqësues nga universitete shqiptare, me synim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe aftësive për menaxhimin e mosmarrëveshjeve në inovacion dhe zhvillim teknologjik.

Webinarin e organizon Qendra e Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit e WIPO, e cila përfshin leksione me tematika dhe ligjërues ndërkombëtarë.

Një nismë që ndihmon DPPI-në dhe partnerët akademikë, të forcojnë njohuritë dhe praktikën në fushën e inovacionit dhe pronësisë intelektuale.

- **Misioni i ekspertëve të WIPO për mbështetjen e brandimit dhe komercializimit të Treguesit Gjeografik Vaji i Ullirit “Valmi Elbasan”**



Misioni i ekspertëve të WIPO për mbështetjen e brandimit dhe komercializimit të Treguesit Gjeografik Vaji i Ullirit “Valmi Elbasan” u zhvillua në Shqipëri në dhjetor, 2025.

Ekipi përbëhet nga ekspertët z. Pascal Bernandoni, znj. Virag Halgand dhe znj. Brunhilda Stamo. Projekti do të zgjasë 1 vit, duke synuar rezultate konkrete për prodhuesit dhe institucionet.

Në takimin e mbajtur në DPPI, u diskutua mbi ecurinë e deritanishme, fazat kryesore dhe bashkëpunimin institucional për forcimin e sistemit të TGJ-ve në Shqipëri.

Gjatë misionit, ekipi zhvilloi takime me AIDA, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCIT), Shoqatën e Hotelierëve, si dhe ALSIP.

Misioni zhvillohet në bashkëpunim mes WIPO, DPPI dhe institucioneve kombëtare, me fokus rritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen konkrete për prodhuesit e TGJ-ve gjatë gjithë periudhës së projektit.

- **Vizita e Ekspertëve të Zyrës Evropiane të Patentave në Shqipëri**

Bashkëpunim për forcimin e kapaciteteve kombëtare në kërkimin dhe ekzaminimin e patentave.

Në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën Evropiane të Patentave (EPO), gjatë muajit tetor, në kuadër të projektit pilot të financuar nga EPO, që synon forcimin e kapaciteteve të ekzaminuesve në zyrat kombëtare të patentave.

Trajnimi u drejtua nga mentorët e EPO-së, z. Alan Bacon dhe z. Charalampos Tompouloglou, ish-ekzaminues me përvojë të gjatë në fushën e patentave.

Gjatë punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, u zhvilluan sesione praktike mbi:

- klasifikimin ndërkombëtar të patentave sipas IPC (International Patent Classification)
- konceptin e unitetit të shpikjes
- kërkimin e të dhënave mbi patenta të mëparshme në sistemin Espacenet; si dhe
- Draft-imin e opinionit të kërkimit mbi rezultatet e gjetura.

- **Një hap i rëndësishëm për Shqipërinë në WIPO**

Në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të 66<sup>të</sup> të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), e mbajtur në Gjenevë, u zhvillua një takim bilateral ndërmjet përfaqësuesve të Republikës së Shqipërisë dhe drejtuesve të WIPO-s, me fokus në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e pronësisë industriale.

Një nga momentet më të rëndësishëm të këtij takimi, ishte nënshkrimi nga Shqipëria i Traktatit Ndërkombëtar për Disajnin Industrial ("Design Law Treaty").

Ky traktat, i miratuar në një konferencë të nivelit të lartë në Riad, përfaqëson një nismë strategjike për thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave ndërkombëtare në fushën e regjistrimit të disajnit industrial dhe rrit ndjeshëm pjesëmarrjen e Shqipërisë në zhvillimet bashkëkohore të pronësisë intelektuale në nivel global.

- **Takim rajonal mes përfaqësuesve të katër vendeve të Ballkanit Perëndimor**

Në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të 66<sup>të</sup> të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), u zhvillua një takim rajonal mes përfaqësuesve të katër vendeve të Ballkanit Perëndimor, Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë me Drejtorin Ekzekutiv të Zyrës së Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPO), z. João Negrão, si dhe me përfaqësues të ekipit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar të kësaj zyre.

Gjatë takimit u bë e ditur se, në vitin 2026 pritet të nisë zbatimi i një projekti të ri rajonal për Ballkanin Perëndimor, financuar nga fondet e para-anëtarësimit të BE-së dhe i zbatuar nga EUIPO.

Projekti do të synojë:

- përmirësimin e kuadrit ligjor,
- forcimin e kapaciteteve institucionale,
- digjitalizimin e administratave të pronësisë intelektuale
- promovimin e bashkëpunimit rajonal (duke përfshirë CEFTA)
- rritjen e ndërgjegjësimit për vlerën ekonomike të pronësisë intelektuale.
- Përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE- së,

Po ashtu, një vëmendje e veçantë do ti kushtohet trendeve të reja globale që ndikojnë zhvillimin e sistemit të pronësisë industriale.

Forcimin e bashkëpunimit me EUIPO

- Zbatimin e “Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025”.
- **Takim në kuadër të konferencës së nivelit të lartë për Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, me zëvendës-presidentin për Çështjet Ligjore dhe Ndërkombëtare në Zyrën Evropiane të Patentave (EPO), z. Christoph Ernst.**



Në kuadër të konferencës së nivelit të lartë për Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, u zhvillua një takim i rëndësishëm mes zëvendësministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Sokol Duma, dhe zëvendës-presidentit për Çështjet Ligjore dhe Ndërkombëtare në Zyrën Evropiane të Patentave (EPO), z. Christoph Ernst.

Takimi u organizua nga Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar, i DPPI-së znj. Maria Solis dhe kishte për qëllim fuqizimin e marrëdhënieve mes institucioneve shqiptare dhe EPO.

U rikonfirmua bashkëpunimi i ngushtë mes Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Zyrës Evropiane të Patentave, me synimin për të çuar përpara plane konkrete dhe për të forcuar partneritetin dypalësh.

Ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të pronësisë industriale në Shqipëri dhe integritet më të plotë në rrjetin evropian të inovacionit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave.

- **Vizita Studimore e Zyrës homologe Greke të Pronësisë Industriale, në Tiranë**

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) priti në Tiranë një delegacion nga Zyra Greke e Pronësisë Industriale të Republikës Helene, në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë mes institucioneve respektive.

Përbërja e Delegacionit:

- z. Panagiotis Kanellopoulos - Drejtor i Përgjithshëm i Zyrës Helene të Pronësisë Industriale
- znj. Catherine Margellou – Zëvendësdrejtore dhe Drejtore e Mbështetjes Ligjore
- znj. Myrto Lambrou Maurer – Përgjegjëse për Çështjet Ndërkombëtare

Delegacioni u mirëprit nga Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar i DPPI-së, së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse.

DPPI, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën Helene të Pronësisë Industriale, me qëllim forcimin e marrëdhënieve institucionale dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e pronësisë industriale.

Objektivat e Vizitës:

- Shkëmbimi i praktikave më të mira mbi proceset e digjitalizuara të aplikimeve
- Raportet e kërkimit dhe procedurat e ekzaminimit
- Diskutime mbi përditësimet ligjore dhe shkëmbimi i informacionit mbi legjislacionin e pronësisë industriale

Ky bashkëpunim ndihmon në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e shërbimeve për inovatorët dhe bizneset.

## **KONFERENCA/WORKSHOP-E**

- **Seminar mbi Sistemin Ndërkombëtar të Patentimit PCT**



Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), organizoi një seminar mbi Sistemin Ndërkombëtar të Patentimit PCT, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndërkombëtarizimin e inovacionit shqiptar, me përfaqësues nga Zyra e Pronësisë Industriale e Maqedonisë së Veriut, duke shërbyer si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e pronësisë industriale. Aktiviteti vijoi me sesione informuese me përfaqësues nga universitetet, qendrat e inovacionit dhe agjencitë e inovacionit.

Qëllimi i këtij seminari ishte forcimi i njohurive mbi procedurat ndërkombëtare të patentimit, rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e mbrojtjes së shpikjeve dhe promovimi i përdorimit të sistemit PCT si një mjet strategjik për daljen e inovacionit shqiptar në tregjet globale.

Aktiviteti u përshëndet nga Drejtori i Përgjithshëm i Komanduar i DPPI-së, znj. Bollano, e cila e vlerësoi maksimalisht këtë seminar si një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e njohurive dhe aftësive profesionale, në fushën e pronësisë industriale.

Ky seminar, përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërkombëtarizimit të inovacionit shqiptar dhe forcimit të kapaciteteve profesionale në fushën e pronësisë industriale.

## **Takime me bizneset**

Gjatë këtij viti janë realizuar takime direkte me biznese lokale në disa qytete të Shqipërisë, me fokus ndërgjegjësimin mbi objektet e pronësisë industriale dhe përfitimet nga regjistrimi i tyre përfshirë qytetet si : Berat, Vlorë, Pogradec, Kukës, Tepelenë, Dibër, Malësi e Madhe, Tropojë, Dhërmi, Himarë, Sarandë, Pukë, Voskopojë, Ersekë, Përmet, Roskovec, Tropojë. Duhet theksuar fakti që në qytetin e Tiranës fushatat dhe takimet informuese, zhvillohen më shpesh dhe në shumë subjekte tregtare.

Këto takime kanë kontribuar në:

- Rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve mbi rëndësinë e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale,
- Informimin mbi procedurat e regjistrimit dhe përfitimet ekonomike që rrjedhin nga mbrojtja ligjore,
- Vendosjen e komunikimit të drejtpërdrejtë me bizneset lokale, veçanërisht në zona me akses të kufizuar në informacion,
- Bashkëpunim me autoritete vendore (Kryetarët e Bashkive) për lehtësimin e komunikimit me bizneset lokale.



## **Bashkëpunimi me universitetet dhe trajnimet**

Gjatë vitit raportues është vijuar bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë, përmes organizimit të trajnimeve, leksioneve të hapura dhe aktiviteteve informuese për studentët.

Janë zhvilluar disa trajnime universitare me pjesëmarrjen e mbi 40 studentëve, për çdo trajnim në universitet të ndryshme si: “Universiteti Epoka”, Universiteti “European i Tiranës”, “Fakulteti Juridik”, Universiteti “Luigj Gurakuqi “ Shkodër, “Universitetin Bedër”, Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, Western Balkans University, Fakulteti Ekonomik në UT, Instituti Kanadez i Teknologjisë, Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, Institutit “Harry Fultz.

Këto aktivitete kanë shërbyer për:

- Rritjen e njohurive të studentëve mbi pronësinë industriale;
- Nxitjen e kulturës së inovacionit dhe mbrojtjes së ideve;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet DPPI-së dhe universiteteve.

### **Qendrat e Informacionit Tekniko-Shkencor**

DPPI administron 5 Qendra të Informacionit Tekniko-Shkencor (Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Tiranë, Vlorë) të cilat gjatë vitit 2025 janë vizituar dhe aktivizuar dy herë në vit, duke realizuar në total 10 aktivitete informuese.

Këto qendra kanë shërbyer si pika referimi për:

- Studentë dhe stafet akademikë;
- Ofrimin e informacionit teknik dhe shkencor në fushën e pronësisë industriale
- Rritjen e aksesit në informacion në nivel rajonal
- Konsolidim i rolit të DPPI-së si pikë referimi për informacionin shkencor dhe teknologjik.



### **Pjesëmarrja në panairë dhe aktivitete promovuese**

Gjatë vitit 2025, DPPI, ka marrë pjesë në 4 panairë dhe evente kombëtare, ndër të cilat:

- Future Tech
- Medical and Beauty Fair
- Panairi i Lushnjës
- Tirana Agro

Pjesëmarrja në këto panairë ka kontribuar në:

- Rritjen dhe njohjen e institucionit të DPPI-së
- Promovimin e produkteve shqiptare dhe të inovacionit
- Krijimin e kontakteve me aktorë të rinj të ekosistemit të inovacionit
- Kontakt me një audiencë më të gjerë biznesesh, start-up-esh dhe të rinjsh




### *Aktivite të tjera promovuese*

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, ka ngritur stenda informuese në pika kyçe të kyeqytetit, për të theksuar rëndësinë e regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale si dhe vendosjen të dispozicion të broshuarave informuese, lidhur me objektet e PI-së.




Gjithashtu, janë zhvilluar 2 trajnime dhe leksione tematike në bashkëpunim me Dhomat e tregtisë Shqiptare dhe Franceze dhe 4 trajnime me Aktorë të sektorit privat.



Në kuadër të forcimit të kapaciteteve, bashkëpunimit me sistemin arsimor si dhe partnerëve tanë ndërkombëtar, gjatë vitit 2025, DPPI zhvilloi me mësues të sistemit të arsimit parauniversitar trajnimin online në fushën e Pronësisë Intelektuale, ofruar nga përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Drejtorisë për të Drejtën e Autorit.

Ky trajnim paraprak i hapi rrugë programit 3-ditor që do të mbahet më 24–26 shtator, i ofruar nga ekspertë të Akademisë së Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO). Me këtë nismë.

synohet që mësuesit të bëhen ura lidhëse për përhapjen e njohurive mbi pronësinë industriale dhe mbrojtjen e krijimtarisë të nxënësit.



Për të dytin vit rradhazi, mësuesit e sistemit parauniversitar të qytetit të Tiranës, patën mundësinë të ndiqnin Programin Kombëtar të Trajnimit për Mësuesit e Sistemit Parauniversitar në Shqipëri – IP4Youth & Teachers, në datat 24–26 Shtator 2025, i ofruar nga Akademia e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO).

Në këtë program kanë marrë pjesë:

- 40 mësues me profil nga teknologjia dhe shkenca
- Përfaqësues nga programet Start-Up
- Përfaqësues nga Kurrikula
- Përfaqësues nga Ministria e Arsimit

Ky trajnim ka kontribuar në:

- Rritjen e njohurive mbi pronësinë intelektuale në sistemin parauniversitar
- Integrimin e koncepteve të pronësisë intelektuale në procesin mësimor
- Forcimin e bashkëpunimit institucional me WIPO dhe institucionet kombëtare.



Në bashkëpunim me "Challenge & Found dhe bashkëpunim me Partners", DPPI zhvilloi një trajnim të dedikuar për sipërmarrësit e rinj, me fokus të rëndësia e mbrojtjes së markave, disajneve, shpikjeve dhe aseteve të tjera të pronësisë intelektuale.

Qëllimi i trajnimit ishte informimi i start-up-eve mbi domosdoshmërinë e mbrojtjes ligjore të markës dhe të inovacionit, si një element thelbësor për ndërtimin e një biznesi të qëndrueshëm.

Ky bashkëpunim, përfaqëson përkushtimin tonë për të mbështetur komunitetin e start-up-eve, duke ofruar njohuri të nevojshme për të mbrojtur identitetin dhe asetet e tyre në treg.





*Mbrojtja e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale, është një nga aspektet më të rëndësishme të rregulluara nga legjislacioni mbi pronësinë industriale.*

### MIRATIMI DHE HYRJA NË FUQI E LIGJEVE NR. 52/2025 DHE NR. 53/2025

Një nga zhvillimet kryesore të vitit 2025 ka qenë miratimi dhe hyrja në fuqi më 16 gusht 2025 e:

- Ligjit nr. 52/2025 “Për markat tregtare”
- Ligjit nr. 53/2025 “Për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë”

Këto ligje, krijojnë një reformë të thellë të kuadrit ligjor të pronësisë industriale dhe sigurojnë harmonizim me standardet e Bashkimit Evropian.

### TRAKTATE DHE MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2025, DPPI ka ndjekur procedurat për miratimin e:

- Projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin për Pronësinë Intelektuale, Burimet Gjenetike dhe Njohuritë Tradicionale të lidhura me to” (Gjenevë, 24 maj 2024)
- Projektligjit “Për ratifikimin e Traktatit të Riadit për Disenjot dhe Rregullores sipas këtij Traktati” (Riad, 22 nëntor 2024)

Të dy projektligjet u miratuan nga Këshilli i Ministrave, gjatë vitit 2025.

## HARTIMI DHE NDJEKJA E PROJEKTVENDIMEVE DHE PROJEKTLIGJEVE

DPPI ka përgatitur dhe dërguar për miratim pranë ministrisë përgjegjëse ndryshimet dhe projektligjet e mëposhtme:

- Projektvendimi për disa ndryshime në Vendimin nr. 457, datë 3.7.2019 (procedurat e Qendrës së Trajnimeve dhe tarifat përkatëse);
- Projektvendimi për disa ndryshime në Vendimin nr. 752, datë 19.12.2018 (rregullorja e Bordit të Apelit dhe masat e shpërblimit);
- Projektvendimi për disa ndryshime në Vendimin Nr. 252, datë 09.5.2018 (masat dhe kriteret e shpërblimit të Këshillit Mbikëqyrës);
- Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Singaporit mbi ligjin e Markave Tregtare”;
- Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Traktatin e Najrobit për mbrojtjen e Simbolit Olimpik”;
- Memo informuese lidhur me ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 325 datë 31.05.2023 (strukturat e pagave dhe shtesat për natyrë të veçantë pune).

### Tabela përmbledhëse e veprimtarisë (2024–2025)

Treguesi	2024	2025
Çështje në Dhomën për Shfuqizim dhe Pavlefshmëri	25	40
Çështje gjyqësore të ndjekura nga DPPI	12	22
Çështje në proces shqyrtimi / pritje vendimi	5	20
Vendime gjyqësore në favor të DPPI-së	4	2

### **Kapitulli 7 “E drejta e Pronësisë Intelektuale”: Një shembull sukcesi në rrugën evropiane të Shqipërisë**

Në rrugën e gjatë dhe të ndërlikuar të integrimit evropian, çdo kapitull negociatash përbën një gur themeli në procesin e përafrimit të Republikës së Shqipërisë me standardet e Bashkimit Evropian. Mes 35 kapitujve, Kapitulli 7 – E drejta e Pronësisë Intelektuale (PI) – është shquar për progresin e tij të prekshëm, duke u kthyer në një shembull frymëzues edhe për fushat e tjera. Ky kapitull, nuk është thjesht një detyrim i procesit të integrimit; ai është një investim strategjik në inovacion, kreativitet dhe zhvillim të qendrueshëm ekonomik.

#### **Rëndësia e Kapitullit 7**

Sistemi i pronësisë intelektuale garanton mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura, si dhe të pronësisë industriale – përfshirë markat tregtare, patentat, modelet e përdorimit, disenjot industriale, si edhe treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës. Ky sistem përbën bazën e një ekonomie konkurruese dhe të orientuar drejt dijes, duke krijuar siguri juridike për krijuesit, inovatorët dhe sipërmarrësit shqiptarë.

Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, mbrojtja efektive e ideve, disenjove industriale, produkteve kreative dhe shpikjeve nuk është vetëm një kërkesë ligjore – është një motor i fuqishëm i zhvillimit, një garanci për konkurrueshmëri dhe një shtysë thelbësore drejt rritjes ekonomike të vendit.

#### **Ecuria e Shqipërisë në Kapitullin 7**

Shqipëria ka shënuar përparime të konsiderueshme në harmonizimin e kuadrit ligjor me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian në fushën e Pronësisë Intelektuale. Në vitet e fundit, është duke u realizuar një proces i thelluar modernizimi të legjislacionit, duke përfshirë ndryshime dhe përditësime në ligjet që rregullojnë markat tregtare, patentat, modelet e përdorimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, në përputhje me standardet dhe praktikatat më bashkëkohore evropiane.

Po ashtu, kuadri ligjor mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura është forcuar ndjeshëm, duke u përafruar me direktivat e BE-së për mbrojtjen e veprave në mjedisin analog dhe veçanërisht në atë digjital. Kjo ka rritur mbrojtjen e krijuesve dhe ka kontribuar në vendosjen e një tregu më transparent dhe më të drejtë për aktorët kreativë dhe ekonomikë.

Udhërrëfytyesi kryesor i reformave mbetet Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022–2025, e cila përcakton prioritetet strategjike të fushës. Strategjia synon forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e eficiencës së shërbimeve publike përmes digjitalizimit, rritjen e transparencës dhe garantimin e një administrimi modern dhe efikas të të drejtave të PI-së. Një komponent i rëndësishëm i strategjisë është edhe rritja e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e sistemit të pronësisë intelektuale si motor zhvillimi për inovacionin, konkurrueshmërinë dhe krijimtarinë në Shqipëri.

#### **Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përputhja me standardet e BE-së**

Shqipëria ka intensifikuar bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare kryesore në fushën e PI-së, si:

- Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO),
- Zyra Evropiane e Patentave (EPO),
- Zyra e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPO).

Këto partneritete kanë mundësuar realizimin e projekteve të asistencës teknike, modernizimin e strukturave, përmirësimin e praktikave të shqyrtimit, si dhe trajnime të specializuara për stafin dhe komunitetin e inovacionit. Po ashtu, bashkëpunimi me Komisionin Evropian ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe konsistencës me *acquis*-in.

### **Edukimi dhe ndërgjegjësimi publik**

Shqipëria ka bërë hapa të veçantë në fushën e edukimit mbi pronësinë intelektuale. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, është hartuar një kurrikul kombëtare për trajnimin e mësuesve, duke integruar konceptet e PI-së në arsimin parauniversitar dhe duke ndikuar tek të rinjtë, universitetet dhe startup-et. Kjo qasje e bën edukimin mbi pronësinë intelektuale një pjesë të natyrshme të kulturës shoqërore dhe ekonomike.

### **Piketat mbyllëse për mbylljen e kapitullit**

Për çdo kapitull negociues, BE-ja vendos “piketa hapëse” (opening benchmarks) dhe “piketa mbyllëse” (closing benchmarks) që duhet të përmbushen përpara se kapitulli të konsiderohet i mbyllur.

Këto piketa nuk janë vetëm kritere ligjore, por standardë praktikë që matin aftësinë e një vendi për të zbatuar në mënyrë efektive rregullat e BE-së.

Për ta përmbyllur plotësisht Kapitullin 7, Republika e Shqipërisë, duhet të përmbushë disa piketa, konkretisht:

1. Harmonizim i plotë ligjor me *acquis* të BE-së, përfshirë të drejtat e autorit në mjedisin digjital dhe të drejtat e pronësisë industriale.
2. Forcim i bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër falsifikimeve dhe piraterisë.
3. Modernizim i mëtejshëm i shërbimeve elektronike të regjistrimit të PI-së.
4. Zbatim efektiv i mbrojtjes on-line në përputhje me direktivën e tregut të përbashkët digjital.
5. Vijimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit për profesionistët dhe publikun.

Kapitulli 7, është një shembull suksesi i përkushtimit dhe vizionit të Shqipërisë në procesin e integritimit evropian. Ai demonstroi se mbrojtja e pronësisë intelektuale është jo vetëm një kërkesë ligjore, por edhe një motor zhvillimi dhe inovacioni, duke kontribuar në ndërtimin e një Shqipërie të qëndrueshme, konkurruese dhe të integruar në ekonominë e dijes evropiane.

Përmbushja e pikëve mbyllëse në këtë kapitull, do të përbëjë një hap të rëndësishëm drejt mbylljes së grupit të kapitujve për tregun e brendshëm dhe një sinjal pozitiv për ritmin e përgjithshëm të

negociatave të Shqipërisë me BE-në. Ky kapitull, pritet të mbyllet në vitin 2026 duke u renditur ndër kapitujt e parë që do mbyllin fazën e piketave përmbyllëse.

Në këtë kontekst, Republika e Shqipërisë, hyn në një fazë të re të procesit të negociatave, ku fokusi mbetet tek përmbyllja e piketave mbyllëse dhe konsolidimi i arritjeve ekzistuese, për ta bërë sistemin e saj të pronësisë intelektuale, plotësisht të përputhshëm me standardet e Bashkimit Evropian dhe për ta shndërruar atë në një motor të qëndrueshëm të inovacionit dhe zhvillimit kombëtar.

## **STRATEGJIA KOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE 2022-2025**

---

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në rolin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës, ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr.118, datë 23.9.2020, si dhe me mbështjetjen e institucioneve të përfshira në këtë proces, ka propozuar hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të PI-së.

Kjo strategji, përfshin një grup rregullash, të cilat do të përcaktohen dhe implementohen nga institucionet e përfshira në sistemin e PI-së për të inkurajuar dhe forcuar zhvillimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e PI-së në nivel kombëtar. Ajo do të konkretizojë përpjekjen themelore për vendosjen e dialogut gjithpërfshirës ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke krijuar kushte të përshtatshme për mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale.

Qëllimet e kësaj Strategjie janë:

- stimulimi i zhvillimit ekonomik, shkencor dhe kulturor në vend
- sigurimi i mirëfunksionimit të tregut të brendshëm, duke vendosur ekuilibrin e duhur midis interesave të pronarëve të drejtave të pronësisë intelektuale dhe interesave të përdoruesve
- forcimi i sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së pronës intelektuale.

Strategjia ka pesë objektiva:

1. përmirësimi i kornizës ligjore;
2. zhvillimi dhe forcimi i kornizës institucionale;
3. forcimi i koordinimit dhe i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, si në nivelin kombëtar, rajonal ashtu edhe atë ndërkombëtar;
4. ngritja e vetëdijes për rëndësinë e sistemit të pronësisë intelektuale;
5. identifikimi i treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës.

Nëpërmjet kësaj Strategjie, rezultatet që u arritën, janë:

- Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe legjislativ në fushën e pronësisë intelektuale;

- Forcimi i kapaciteteve administrative të institucioneve të përfshira në sistemin e PI-së;
- Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut (organizimi i seminareve, konferencave dhe aktiviteteve promovuese);
- Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve të përfshira në fushën e PI-së;
- Forcimi i sistemit të zbatimit dhe të mbrojtjes së PI-së;
- Nxitja dhe hartimi i politikave për regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës, si aset dhe interes kombëtar;
- Komercializimi i objekteve të PI-së, si edhe transferimi i teknologjisë.

Ky dokument, u hartua me kontributin e ekspertëve të grupit ndërinstitucional të punës, të ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr.118, datë 23.09.2020 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për bashkërendimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të dokumentit strategjik për Pronësinë Intelektuale 2021-2025” si dhe me asistencën teknike të ofruar nga ekspertët e Organizatës Botërore për Pronësinë Intelektuale (OBPI) si një nga partnerët tanë më të rëndësishëm, në rrugëtimin e institucioneve për një sistem të qëndrueshëm të pronësisë intelektuale.

Kjo strategji, është një nga arritjet më të rëndësishme në reformat që ka ndërmarrë qeveria shqiptare në fushën e pronësisë intelektuale, si një gur themeli dhe hap i domosdoshëm drejt procesit të integritimit evropian, çka tregon, se institucionet shqiptare dinë të ndërmarrin reforma dhe t’i kthejnë ato në objektiva të matshme dhe të arritshme. Ndaj, miratimi i dokumenteve të tilla strategjike, është një provë e përmirësimit të punës dhe të veprimtarisë së institucioneve.

Në 20 qershor 2025, u zhvillua mbledhja e parë e vitit, e Grupit Ndërinstitucional të punës (GNP) për monitorimin e “Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025”.

Kjo mbledhje u drejtua nga Kryetari i GNP, zëvendësministri për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin Z. Sokol Duma. Me pjesëmarrjen e të gjithë institucioneve kontribuese, të cilët diskutuan bashkërisht arritjet e parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë për 6-mujorin e parë, si dhe detyrat kryesore për t’u përmbushur për 6- mujorin e dytë të vitit 2025.

Ndërsa, mbledhja e dytë dhe e fundit për vitin 2025, u mbajt më 22 dhjetor. Grupi i punës, diskutoi aktivisht mbi arritjet për 6-mujorin e dytë të vitit 2025. Sfidat mbeten të pranishme dhe e ardhmja kërkon një vizion të ri dhe një qasje edhe më bashkëkohore, duke qenë se jemi dhe pjesë e një momenti historik për Shqipërinë, siç është integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

## I. STATISTIKA

### **Të ardhurat financiare janë tregues i rëndësishëm i performancës së një institucioni.**

Veprimtaria e DPPI-së financohet nga të ardhura të krijuara nga kryerja e veprimtarisë së saj në zbatim të ligji 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Në bazë të pikës 1 të nenin 191/a, të Ligjit 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, të ardhurat që realizon DPPI-ja janë:

a) të ardhurat që krijohen nga aktiviteti i saj;

b) të ardhurat nga tarifat e Sistemit të Madridit, për regjistrimin e markave ndërkombëtare,

Marrëveshjes së Hagës për aplikimet ndërkombëtare për diseno industriale, si dhe të gjitha marrëveshjet e tjera që Republika e Shqipërisë ka lidhur ose do të lidhë në fushën e pronësisë industriale;

c) të ardhura të tjera që mund të krijohen sipas legjislacionit në fuqi.

DPPI-ja ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet të administrojë asetet e llogaritë e saj bankare pas hyrjes në fuqi të Ligjit 9947/2008.

Të ardhurat financiare përbëjnë një indikator të rëndësishëm të performancës institucionale. Treguesit financiarë reflektojnë një ecuri pozitive për DPPI-në, duke dëshmuar një menaxhim eficient të burimeve dhe realizim të objektivave strategjike. Aktiviteti i Drejtorisë nuk është kufizuar vetëm në zbatimin e funksioneve të saj bazë për regjistrimin dhe administrimin e objekteve të pronësisë industriale, por është shtrirë edhe në forcimin e rolit institucional përmes promovimit dhe formalizimit të pronësisë industriale. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë hapa konkretë për të nxitur personat fizikë dhe juridikë, nëpërmjet zyrave tona, që të investojnë duke regjistruar pronën e tyre industriale. Ky orientim strategjik i investimeve synon të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të sektorit dhe të mbështesë qëndrueshmërinë e bizneseve vendase.

Të ardhurat e DPPI-së përbëhen nga:

1. Aktiviteti kryesor, aplikime kombëtare,
2. Të trashëguara. investime, projekte në vazhdim,
3. Të ardhurat nga mbrojtja e markave nga Marrëveshja e Madridit dhe Protokollin e saj për regjistrimin ndërkombëtar të markave,
4. Marrëveshja e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove,
5. Të ardhura nga ZEP për regjistrimin ndërkombëtar të patentave.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të ardhurat sipas zërave të buxhetit, dhe realizimi në përqindje duke krahasuar vlerat e planifikuara me ato faktike për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

(Në mijë lekë)

Nr.	ZËRAT	PLAN viti 2025	FAKT viti 2025 Realizimi	Fonde të disponueshme	Në %
<b>A.</b>	<b>TË ARDHURAT</b>				
<b>KL. 7</b>					
1	Aktivitet kryesor, aplikime kombëtare	196,000	205,101	(9,101)	<b>105%</b>
2	Marrëveshje e Madridit	65,000	64,407	593	<b>99%</b>
3	Marrëveshja e Hagës	1,400	2,374	(974)	<b>170%</b>
4	Të ardhura nga ZEP	100	524	(424)	<b>524%</b>
	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE</b>	<b>262,500</b>	<b>272,406</b>	<b>(9,906)</b>	<b>104%</b>

Në bazë të tabelës së të ardhurave të paraqitura për periudhën Janar - Dhjetor 2025, analiza e ecurisë ekonomike të DPPI-së tregon këto zhvillime kryesore:

#### **A. Analizë e Përgjithshme e Performancës së të Ardhurave:**

- Totali i të ardhurave të planifikuara për vitin 2025 është 262,5 milionë lekë.
- Të ardhurat e realizuara deri në datën 31 Dhjetor 2025 janë 272,4 milionë lekë, që përfaqëson një realizim prej 104% ndaj planit vjetor.
- Ky nivel realizimi është pozitiv, duke treguar që performanca vjetore e institucionit është e qëndrueshme duke tejkaluar edhe më tepër objektivat vjetore në mbylljen e vitit ushtrimor.

##### 1. Aktiviteti kryesor, aplikime kombëtare:

- Realizim:  $(205,101 / 196,000)$  mijë lekë = 105%
- Ky është zëri me kontributin më të lartë në total. Vlera e parashikuar e të ardhurave nga aktiviteti kryesor (aplikime kombëtare) për vitin 2025 është parashikuar në masën 196 milionë lekë pasi në DPPI pati aplikime të sukseshme mbi rregjistrimin e objekteve të PI-së duke u shtuar numri i tyre i rregjistrimit. Nga arkëtimi i të ardhurave rezulton se dhe ky gjithashtu është një vit i mirë për performancën financiare të DPPI dhe si rezultat i automatizimit të shërbimeve institucioni u përshtat me zhvillimet e reja, si pjesë e një mjedisi digjital, duke u fokusuar në detyrat prioritare, siç është cilësia e shërbimit në ekzaminimin e objekteve të pronësisë industriale.

## 2. Marrëveshja e Madridit:

- Realizim:  $(64,407 / 65,000)$  mijë lekë = 99%

- Këto janë të ardhurat e arkëtuara nga aplikimet e markave ndërkombëtare sipas Marrëveshjes së Madridit dhe Protokollit të Marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave. Këto aplikime dhe pagesa bëhen në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale. Kur aplikanti vendos të zgjedhë Shqipërinë si vend që do të regjistrojë markën e tij, atëherë aplikimi dhe pagesa i dërgohet DPPI, në zbatim të bazës ligjore. Kjo vlerë e parashikuar është llogaritur bazuar në faktin e aplikimeve dhe koeficientin e llogaritjes të dërguar nga OBPI me kërkesën e DPPI. Këto të ardhura zakonisht transferohen brenda 4 mujorit të parë të vitit dhe janë një faktor që ndikon në rritjen e të ardhurave të institucionit dhe likuiditetit. Ky realizim tregon eficiencë të lartë në mbledhjen e të ardhurave për këtë segment dhe ndoshta interes në rritje për mbrojtjen ndërkombëtare të markave.

## 3. Marrëveshja e Hagës:

- Realizim:  $(2,374 / 1,400)$  mijë lekë = 170%

- Këto janë të ardhurat e arkëtuara nga aplikimet e markave ndërkombëtare sipas Marrëveshjes së Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale. Këto aplikime dhe pagesa bëhen në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale. Kur aplikanti vendos të zgjedhë Shqipërinë si vend që do të regjistrojë markën e tij, atëherë aplikimi dhe pagesa i dërgohet DPPI, në zbatim të bazës ligjore. Në vitin muajin Mars të vitit 2025 është arkëtuar shuma prej 853 mijë lekësh, e cila ka qenë një detyrim i prapambetur i 2024, si pasojë e disa problemeve nga numri i llogarisë së OBPI kundrejt llogarisë së DPPI. Për këtë arsye, realizimi i vitit 2025 është më i lartë, por për vitin 2026 nuk parashikohet të ketë më të ardhura të palikuiduara nga OBPI.

## 4. Të ardhurat nga ZEP:

- Realizim:  $(524 / 100)$  mijë lekë = 524%

- Ky zë i të ardhurave është në zbritje dhe pritet të shkojë në zero. Kjo për faktin se që prej datës 1 Maj 2010, Shqipëria është vend anëtar i Zyrës Evropiane të Patentave (ZEP). Aplikimet e depozituara në ZEP pas kësaj date trajtohen në zbatim të Konventës Evropiane të Patentave e cila nuk parashikon transferim të tarifës së grumbulluar nga ZEP. Këtë tarifë DPPI e ka parashikuar ta grumbullojë në fazën e aplikimit pranë DPPI dhe konsiderohet si e ardhur nga aktiviteti kryesor. Pagesa që transferohet në llogarinë e DPPI-së është vetëm për aplikimet që janë depozituara në ZEP para datës 1 Maj 2010, por që nuk ka përfunduar ende ekzaminimi dhe që nuk janë publikuar. Në muaji Korrik 2025 është bërë gabimisht një pagesë prej 5,000 eurosh në llogarinë e DPPI nga një aplikant, pagesë e cila është rimbursuar, për këtë arsye vlera e realizimit prej 524% është më e lartë se sa efekti neto i të ardhurave të arkëtuara në euro dhe është një rritje fiktive në llogarinë në euro ku kemi të ardhurat e derdhura nga ZEP.

## B. Përfundim ekonomik:

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka realizuar 104% të të ardhurave totale të planifikuara për vitin 2025.

### Shpenzimet që realizon DPPI:

Në zbatim të pikës 3 të nenit 191/a, të Ligjit 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, në shpenzime përfshihen fondet e shpenzuara për paga, sigurime, shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, aktivitete të ndryshme në fushën e pronësisë industriale, brenda dhe jashtë vendit, të gjitha këto të nevojshme për ushtrimin dhe realizimin e funksioneve të DPPI-së, si dhe për pagesat e kontributeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë të PI-së.

Në vijim, do të gjeni një informacion mbi situatën financiare të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

### Shpenzimet e realizuara deri në 31 Dhjetor 2025, janë si më poshtë:

Nr.	ZËRAT	PLAN viti 2025	FAKT viti 2025 Realizimi	Fonde të disponueshme	Në %
1	<i>Totali i shpenzimeve Personeli + transfera me jashtë + Operative</i>	286,446	180,952	105,494	63%
2	<i>Totali i shpenzimeve kapitale</i>	88,912	20,605	68,310	23%
	<b>Totali i Shpenzimeve</b>	<b>375,358</b>	<b>201,557</b>	<b>173,801</b>	<b>53%</b>

(Në mijë lekë)

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, ka vijuar realizimin e buxhetit në përputhje me objektivat e përcaktuara. Të dhënat e raportuara tregojnë një ecure pozitive për shpenzimet Personeli + transfera me jashtë + Operative, me një realizim në nivelin 53% të planit vjetor, duke garantuar funksionimin e vazhdueshëm të institucionit dhe përmbushjen e detyrimeve financiare ndaj stafit dhe shërbimeve të domosdoshme.

Shpenzimet kapitale kanë rezultuar në një nivel realizimi 23%, Fondet e procedurave që nuk janë realizuar përgjatë vitit 2025 janë trashëguar në buxhetin e vitit 2026.

Në total, shpenzimet e përgjithshme për këtë periudhë arrijnë në 58% të buxhetit vjetor, duke marrë në konsideratë edhe derdhjen në buxhet.

## Mirënjohje

---

**Ky raport, u hartua falë punës dhe përkushtimit të punonjësve të DPPI-së.**

**Kontakte:** Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI)

**Adresa:** Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Tiranë, Shqipëri

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)

**Adresa:** Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr. 33, Ish-Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri

**Website:** [www.dppi.gov.al](http://www.dppi.gov.al)

**e-mail:** [info@dppi.gov.al](mailto:info@dppi.gov.al)

**Facebook:** Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale



**Instagram:** Dppi Albania



**LinkedIn:** Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

